

KUJTESË!

Për të realizuar provimin në disiplinën: "Zbatimi në praktikë i legjislationit mbi të drejtën civile, të drejtën penale, legjislationit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë", kandidatëve do tu jepen:

- Testi i provimit,
- Një fletore,
- Një stilolaps

Kandidatët duhet të kenë me vete dokumentin e identifikimit dhe makinë llogaritëse.

Materialet që i lejohen kandidatit në tavolinën e provimit gjatë zhvillimit të provimit janë:

1. Dokument identifikimi
2. Laps, stilolaps, vizore, fshirëse
3. Makinë llogaritëse të thjeshtë pa zhurmë
4. Shishe uji
5. Stilolaps blu për dhënien e zgjidhjeve përfundimtare të testit

Cdo kandidati do ti jepen dy zarfa – një zarf i madh dhe një zarf i vogël, dhe një fletë ku do të shënohet emri, mbiemri dhe numri i kartës ID i cili do të futet në zarfin e vogël nga grupi i verifikimit dhe sekretimit në momentin e verifikimit të identitetit të kandidatit.

Zarfi i madh do të përdoret në përfundim të testimit për të futur në të bashkë zarfin e vogël, fletoren e provimit me zgjidhjet e testit.

Kujdes!

- Kandidatët nuk duhet në asnjë mënyrë të shkruajnë emrin e tyre në fletore dhe as në fletët e tezës.
- Kandidatët duhet të japin përgjigjet e tyre **vetëm në fletore, cdo shënim do të bëhet vetëm tek testi, i cili nuk do të jetë pjesë e sekretimit**. Cdo shënim i tepërt në fletore do të jetë skualifikues.
- Zgjidhja e çdo ushtrimi duhet të jepet në faqe të re, përveç ushtrimeve me alternativë dhe e vërtetë e gabuar.
- Në fletore duhet të tregohet qartë në krye të faqes numri i ushtrimit/pyetjes për të cilin jepet zgjidhja dhe nëse numrat e ushtrimeve/pyetjeve nuk do të jenë progresiv por do të përsëriten për seksione të ndryshme që mund të jetë ndarë testi, atëherë në fletore duhet të shënohet emërtimi i seksioni dhe numri i ushtrimit për të cilin jepet zgjidhja. Zgjidhja duhet të jepet në vijueshmëri në faqet e fletëve të fletores (pra nuk duhet lënë faqe bosh).
- Në rast kur kandidati gjatë përgjigjes kërkon të bëjë një korrigjim të një përgjigjeje të dhënë, fjala ose shprehja duhet të futet në kllapa dhe t'i kalohet një vijë sipër sipas këtij modeli: ~~(standardet ndërkombëtare)~~;
- Pas shpërndarjes së testit, kandidatit nuk i lejohet të dal nga salla e provimit deri në përfundim të kohës së provimit; dhe atëherë vetëm pasi vëzhguesit e provimit të kenë mbledhur të gjitha testet dhe zarfet

e vegjël nga tavolinat e kandidatëve dhe të japin udhëzimin për tu larguar.

- Nëse kandidati do të kërkojë të dalë për një kohë të shkurtër nga salla e provimit, ai do të shoqërohet nga një prej vëzhguesve të sallës së provimit
- Zarfi i vogël do të mbahet i hapur dhe do të mbyllet vetëm nga grupi i verifikimit dhe sekretimit.
- Zarfi i madh do të mbyllet në përfundim të testimit pasi të jetë futur në të zarfi i vogël dhe fletorja e provimit, nga vëzhguesit e sallës në prezencë të kandidatit.
- Celularët do të futen në canta dhe së bashku me to do të vendosen në kreun e sallës. Celularët nuk duhet të jenë në gjëndje pune.
- Nuk lejohet të përdoret asnjë shenjë që do të shërbente për të identifikuar fletoren.

Në rast të konstatimit të një shenje si më sipër, personi do të skualifikohet nga provimi në momentin e sekretimit.

Ndalohet komunikimi i kandidatëve me njëri-tjetrin gjatë provimit. Në qoftë se një gjë e tillë ndodh, atëherë vëzhguesit e provimit janë të detyruar të njoftojnë KPAP.

Në përfundim të kohës së provimit, vëzhguesit e sallës nën prezencën e personelit nga ST dhe SM do të mbledhin fletoren me zgjidhjen e testit dhe zarfin e vogël dhe do ti futin të dy materialet në një zarf të madh, i cili vulozet (në pjesën që mbyll zarfin) në momentin e mbledhjes së materialeve nga tavolina e kandidatit në prezencë të tij. Gjithashtu do të mblidhen të gjitha testet e provimit.

Në përfundim të testimit, duhet nënshkruar përbri emrit tuaj në listë, përpara se të dilni nga salla.

Kualifikohen fitues kandidatët që fitojnë mbi 50% të pikëve të testit.

Ju urojmë SUKSESE!

Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale

Tiranë më, 17 Shtator 2018